



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2327/Prot.
2

Tiranë, më 29.12.2025

VENDIM

Nr. 06, datë 29.12.2025

PËR

MIRATIMIN E LISTËS PËR REDUKTIM 50% NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT, PËR STUDENTËT E CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE (MASTER), PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026 NË UNIVERSITETIN E ARTEVE

Bordi i Administrimit të Universitetit të Arteve, mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 780, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë”, në Urdhrin e Administratorit të Universitetit të Arteve nr. 132, datë 24.10.2025, “Për fillimin e procedurës së pranimit të aplikimeve, nga ana e fakulteteve të UART, për studentët të cilët përfitojnë përjashtim ose reduktim nga tarifa vjetore e shkollimit, për vitin akademik 2025-2026, në Universitetin e Arteve”, bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga çdo student aplikues, shkresat me listat e studentëve aplikantë të përgatitura nga Kryetaret e Degëve dhe Sekretarët Mësimorë të secilit fakultet, pas verifikimeve dhe shqyrtimit e diskutimit nga Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Miratimin e listës për reduktim nga tarifa vjetore e shkollimit, të studentëve aplikues renditur në *Shtojcën nr. 1* bashkëlidhur këtij vendimi që ndjekin studimet në ciklin e dytë të studimeve Master pranë të Fakultetit të Muzikës, Fakultetit të Arteve të Bukura dhe Fakultetit të Artit Skenik në Universitetin e Arteve, për vitin akademik 2025-2026.
2. Ky vendim të përcillet pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL).



3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, Fakulteti i Muzikës, Fakulteti i Artit Skenik, Fakulteti i Arteve të Bukura të Universitetit të Arteve si dhe Drejtoria Ekonomike.
4. Publikimin e vendimit në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Besnik Bisha



(Kryetar)

Anisa Pollo

(Anëtar)

Etjola Kola



(Anëtar)

Prof. Asoc. Dr. Sokol Saraçi

(Anëtar)

Oltjon Muzaka



(Anëtar)

Lorenc Vangjeli

(Anëtar)

Vladimir Llakaj



(Anëtar)

